



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 nen d) si dhe nenit 17 paragrafi 1 nen b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L040 publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.28/2008, dispozitave të nenit 10 paragrafi 2 dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/L-174 G.Z nr.30/2013, nenit 65 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, Udhëzimit Administrativ të MMP nr.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Vendimit për Hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës, 01nr.06-1003/17 të miratuar më datën 24.02.2017, Planit Zhvillimor Komunal, 01nr.06-5941/2015 të datës 26.11.2015, si dhe vendimit për pëlqim mjedisor të MMPH-së për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor për hartat zonale të Komunës së Klinës, nr.19/5322/1 të dt.06.09.2019, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vete të rregullt të datës 31.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028

1. **MIRATOHËT**, Harta Zonale e Komunës së Klinës, për periudhën tetë (8) vjeçare 2020-2028, si një dokument multi- sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private për tere territorin e Komunës së Klinës.
2. Me hartën zonale të Komunës së Klinës, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontest të ndryshimeve të bëra më nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Klinës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, ky vendim hynë në fuqi 15 dite pas delegimit në autoritetin mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores së MAPL nr.01/2017 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.
5. Me vendim të njoftohen: MAPL, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, kryetari i Komunës si dhe Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-4259 /2020
Klinë, 03/02 /2020

